




## THIRRJE PËR PJESËMARRËS:



# Shkolla e 7-të kundër gjuhës së urrejtjes

15.10-19.10.2018

Krushevë

Qendra për Dialog Interkulturore (CID), e përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Shkup, ka kënaqësinë të shpallë thirrje për pjesëmarrës për Shkollën e shtatë kundër gjuhës së urrejtjes.

Qendra për Dialog Interkulturore për vitin e shtatë me rradhë organizon trajnime për punëtorët rinorë, studentët dhe aktivistët, qëllimi kryesor i të cilit është të zhvillojnë aftësitë e tyre për trajtimin e gjuhës së urrejtjes, si dhe të zhvillojnë narrative alternative të bazuara në të drejtat e njeriut.

### Qëllimet:

- Zhvillimi i njohurive dhe aftësive për të menduarit kritik dhe analizimit të gjuhës së urrejtjes si dhe zhvillimi i fjalimit diskutabil;
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi gjuhën e urrejtjes dhe pasojave të mundshme në shoqëri;
- Angazhimi i të rinjve për të kontribuar në luftën kundër gjuhës së urrejtjes përmes organizimit të ngjarjeve dhe aktiviteteve në komunitetet e tyre;
- Zhvillimi i mjeteve, metodave dhe qasjeve për trajtimin e gjuhës së urrejtjes dhe krimin të urrejtjes;
- Krijimi dhe distribuimi i narativave alternative të bazuar në drejtat e njeriut:

Pas përfundimit të trajnimit, nga pjesëmarrësit pritet të bëhen shumëfishues, që nënkupton se ata do të kenë detyrën të zhvillojnë dhe zbatojnë aktivitete në fushën e të drejtave të njeriut me theks të veçantë në ngritjen e vetëdijes për gjuhën e urrejtjes, diskriminimin, si dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes.

### Profili i pjesëmarrësve:

- Mosha mbi 18 vjeç;
- Mundësi për pjesëmarrje në të gjithë trajnimin, dhe pas përfundimit të njëjtit të mund të angazhohen në mënyre aktive në zbatimin e aktiviteteve në komunitetet lokale;
- Të jenë studentë, punëtor rinor dhe /ose edukatorë, aktivistë, anëtarë të organizatave rinore;
- Të kenë njohuri themelore nga fusha e të drejtave të njeriut dhe përvojë të mëparshme në organizimin e aktiviteteve;
- Pas përfundimit të trajnimit, të kenë mundësi të realizojnë një aktivitet të shkurtër në mjedisin në të cilin ata jetojnë dhe veprojnë;

Pjesa e parë e trajnimit do të jetë në internet (online) dhe do të shërbejë si një hyrje në temë dhe njohje reciproke e pjesëmarrësve;

Pjesa e dytë do të mbahet nga 15 deri më 19 tetor 2018 në h. Montana, Krushevë dhe do të përfshijë punëtori dhe ligjerata në këto tema: Gjuha e urrejtjes dhe manifestimet e saj, pasojat e gjuhës së urrejtjes, krimet e urrejtjes, trajtimi i krimit të urrejtjes, mosdiskriminimi, etj.;

Pjesa e tretë përfshin organizimin e aktiviteteve të shkurtra nga pjesëmarrësit në fushat në të cilat ata punojnë dhe veprojnë në lidhje me temat e trajnimit.

Trajnimi do të kryhet nga disa trajnues dhe ekspertë të caktuar në fushat e përmendura.

### **Metoda e aplikimit:**

**Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë duke plotësuar formularin për pjesëmarrje në këtë link: <https://goo.gl/forms/1O8W4yvM4uJKh1GG2>**

**Aplikacionet duhet të dorëzohen deri më 5 tetor 2018.**

Për më shumë informata mund të na kontaktoni në numrin +389 71 390 192 ose email [arta@cid.mk](mailto:arta@cid.mk) dhe /ose [info@cid.mk](mailto:info@cid.mk).

Pjesëmarrësve do tu ndahet certifikatë pas përfundimit të trajnimit.

#### ***Për Qendrën për dialog ndërkulturor:***

Qendra për Dialog Ndërkulturor (CID) është një organizatë e formuar nga të rinjtë për të rinjtë. Ajo punon në mënyrë aktive në promovimin e bashkëpunimit ndërkulturor duke ndërtuar modele për mbështetjen sistematike të të rinjve dhe krijimin e një shoqërie aktive me vlera për jetën së bashku në shoqëri multi-kulturore. Në këtë fushë, CID punon ngushtë me institucionet në aspekte të ndryshme dhe me modalitete të ndryshme të bashkëpunimit.

Misioni i Qendrës për Dialogun Ndërkulturor është të promovojë dhe mbështesë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërkulturor, paqen dhe solidaritetin nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të të rinjve në shoqëri, dhe veçanërisht nëpërmjet angazhimit vullnetar në nivel lokal dhe ndërkombëtar.